



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:159029

Datë: 02.12.2022

Numri i dokumentit: 03706050

**PKR.nr.425/2021**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues Kushtrim Shyti, me zyrtaren ligjore Valbona Shabani, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.D, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve parashikuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.127/2020 e datës 23.07.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 16.11.2022 në prani të Prokurores së Shtetit Besa Limani dhe të pandehurit me avokatin T.G, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.12.2022 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I pandehuri A.D**, i biri i A dhe nënës Sh, e vajzërisë H, i lindur me dt.... në ... .., me vendbanim në lagjen ..., rr. "...", nr ..., K.Prishtinë, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin e gjuhës shqipe, ..., i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 30.08.2016 rreth orës 06:00, i pandehuri ka poseduar armë në atë mënyrë që gjatë bastisjes nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në lagjen ..., rr. "...", nr ..., në ..., në shtëpinë e të pandehurit A.D, gjatë bastisjes të policisë, tek i njëjti janë gjetur dhe sekuestruar një sprej me mbi shkrimin "NATO", një revole e tipit "Cervena zastava" M-83, e kalibrit 357, me numër serik 16841, 25 fishekë të kalibrit 3.75 mm Magnum, një pushkë e gjatë me optikë me mbi shkrimin 7.64 mm bnp 18 tons England-16R3619, si dhe një pushkë automatike A 47 M 70, AB2 1984 me numër serik 235406 dhe tre karikator dhe 31 fishekë të ndryshëm, të cilat i mbante pa autorizim.

-Me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 40, 43, 69, dhe nenit 366 par.1 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365 dhe 366 të KPP-së të pandehurin:

## **E GJYKON**

1. Dënim me gjobë në shumën prej 700.00 (shtatëqind) euro, të cilin dënim-gjobë i pandehuri obligohet ta paguajë 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke ju llogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20 euro ( njëzet euro) dënim me gjobë.
2. Marrja e sendeve. Gjykata, në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe par.2 të KPP-së, si dhe nenit dhe 366 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ndaj të pandehurit lëshon këtë: URDHËR-URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i armëve si në vijim: një sprej me mbi shkrimin "NATO", një revole e tipit "Cervena zastava" M-83, e kalibrit 357, me numër serik 16841, 25 fishekë të kalibrit 3.75 mm Magnum, një pushkë e gjatë me optikë me mbi shkrimin 7.64 mm bnp 18 tons England-16R3619, si dhe një pushkë automatike A 47 M 70, AB2 1984 me numër serik 235406 dhe tre karikator dhe 31 fishekë të ndryshëm, të cilat armë duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi që të vërtetohet se këto armë nuk janë përdorur në ndonjë krim tjetër.
3. Obligohet i pandehuri të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumën prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 70 (shtatëdhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/L.nr.127/2020 e datës 23.07.2021, ndaj të pandehurit A.D, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve parashikuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 16.11.2022, në të cilën ka prezantuar Prokurorja e shtetit Besa Limani dhe i pandehuri A.D me avokatin T.G.

Gjykata vazhdoi seancën e shqyrtimit fillestar ndaj të pandehurit i cili me vullnet të plotë dhe të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/L.nr.127/2020 e datës 23.07.2021, ku ka deklaruar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas aktakuzës.

Prokurorja e Shtetit dha mendimin e saj lidhur me deklarin e fajësisë për të pandehurin A.D, dhe shtoi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale të përshkruar si në aktakuzë, konsideron se ky pranim i fajësisë është bërë konform nenit 248 të

KPRK-së, se ky pranim i fajësisë nga i pandehuri është vullnetar, i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza e cila aktakuzë nuk përmban shkelje ligjore, andaj i ka propozuar gjykatës ta aprovoj këtë pranim të fajësisë.

Mbrojtësi T.G deklaroi: pajtohem në tërësi me atë që tha Prokurorja, z. ... i kam sqaruar të njëjtën gjë siq ja sqaroj gjyqtari lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke qenë i vetëdijshëm në tërësi se si ka ndodhur deri tek kjo situatë e mbajtjes së këtyre armëve që janë gjetur në shtëpinë e tij e të cilën situatë e ka sqaruar tek dëshmia e tij dhënë në prokurori, në tërësi pajtohem me pranimin e fajësisë, duke pasur parasysh pranimin e fajësisë e lusim gjykatën që në rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese e që në rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh pranimin e fajësisë, moshën e A.D, të ketë parasysh atë se ai kurrë më herët nuk ka pas ndonjë dënim si dhe pendimin për rastin të cilën që ka ndodhur duke mos e ditur fare që armët të lëna si kujtim nga djali i tij Arbor Dehari kanë qene funksionale, dhe i premtojmë gjykatës që situata të tilla kurrë nuk do të përsëriten, gjykata të ketë parasysh se kanë kaluar më tepër se 6 vite prej momentit kur armët e përshkruara në dispozitivit të aktakuzës janë gjetur në shtëpinë e tij.

Andaj pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitivin e nenit 248 par.1 të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

Nga thëniet e vet të pandehurit A.D në shqyrtimin fillestar dhe nga pranimi i fajësisë u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti i policisë me numër 2016-AB-2824 i datës 03.09.2016, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve ,deklarata e të pandehurit, foto dokumentacioni, raporti i ekspertizës i datës 03.10.2016 dhe i datës 13.10.2016, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve parashikuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i pandehuri. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me mbajtjen e armës në kundërshtim me ligjin dhe betimin se në të ardhmen nuk do të

përsëris vepra penale, ndërsa rrethana rënduese gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre për faktin se kjo dukuri është në rritje, faktin se armën e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë penale, andaj të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Sa i përket shqiptimit të dënimit me gjobë gjykata ka marr për bazë gjendjen ekonomike të pandehurit andaj i ka shqiptuar dënim me gjobë. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës kishte parasysh se i pandehuri nuk kishte të kaluar kriminale, andaj mori aktgjykim si më lartë, dhe Gjykata vlerëson së një dënim i tillë është i përballueshëm dhe nuk rrezikon ekzistencën e të pandehurit.

*- Konfiskimi:*

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-së, dhe nenit 366 par.3 të KPRK-së, ndaj të pandehurit ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës të përshkruar si në dispozitiv. Gjykata rikujton se i pandehuri se nuk kishte leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 366 par.3 KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të tij.

*-Shpenzimet e procedurës*

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPPRK-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.425/2021 Datë 02.12.2022**

**Zyrtarja Ligjore**  
**Valbona Shabani**

**Kryetari i trupit gjykues -Gjyqtari**

---

**Kushtrim Shyti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën